



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:011050
Datë: 18.10.2024
Numri i dokumentit: 06321650

Ca.nr.6477/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Enes Mehmeti - kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Besnik Feka, anëtar në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.H nga fshati Zhur, Komuna e Prizrenit, me numër personal //, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat Muharrem Kurtaj nga Prishtina, Blv.”Dëshmorët e Kombit” lagja Ulpianë C-2 nr.2/6, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson Vlora Isufi Xhoxhaj, me objekt të padisë kompensimi i shujtave, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.21/23, të datës 13.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **07.10.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.21/23, të datës 13.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.21/23, të datës 13.12.2023, “pa shqyrtim kryesor të çështjes ka vendosur “... në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.H nga fshati Zhur, Komuna e Prizrenit. Në pikën II të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, që paditësit Bedri Hoxhaj, në emër të shujtave ditore për 166 ditë pune të realizuara në vitin 2022 (respektivisht për periudhën prej datës 01.01.2022 e deri më datë 21.11.2022), ti paguaj shumën e përgjithshme prej 332.00 (treqind e tridhjetë e dy) euro, me kamatë ligjore prej

8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 13.01.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimi të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm. Në pikën III e ka detyruar të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00 (njëqind e njëzetë e katër) euro, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm...”

Kundër këtij aktgjykimi, ka parashtruar ankesë e paditura përmes përfaqësueses së autorizuar, për shkak të *shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës, të ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren –Departamenti i Përgjithshëm Civil C.nr.21/23, i datës 13.12.2023 dhe të hedhet poshtë padia e paditësit apo që aktgjykimi i atakuar të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar përgjigje në ankesë me të cilën ka kërkuar që të refuzohet ankesa e të paditurës dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa është e **pa themeltë**.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi përmes të autorizuarit të tij, me dt. 13.01.2023, në gjykatën e shkallës së parë, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit për kompensimin e ushqimit – shujtës ditore, e cila padi është precizuar me datë 08.12.2023, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit paditësit t’ia kompensoj shujtat për ditët e pranisë në punë për vitin 2022, respektivisht nga data 01.01.2022 e deri me datë 21.11.2022 nga 2 euro në ditë, për çdo ditë pune, për 166 ditë pune, në shumën prej 332 euro, sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Po ashtu ka theksuar se e paditura edhe përkundrejt detyrimit nuk ia ka paguar paditësit kompensimin për ditët e pranisë në punë për vitin 2022, ashtu që paditësi i ka propozuar gjykatës që të merr aktgjykim dhe ta aprovjë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Nga ana tjetër e paditura, përmes përgjigjes në padi, e ka kontestuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit për të njëjtat arsye si në ankesë, duke propozuar refuzimin e të njëjtës.

Gjykata e shkallës së parë, në fazën e përgatitjes së lëndës për shqyrtim kryesor të çështjes, pas vlerësimit të deklarimeve të ndërgjyqësve dhe fakteve jokontestuese në mes tyre si dhe provave në shkresat e lëndës që kanë të bëjnë me çështjen konkrete juridike, pasi që janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 152, lidhur me nenin 398 të LPK-së, ka marrë aktgjykimin e goditur “pa shqyrtim kryesor të çështjes”, duke vendosur që kërkesëpadinë e

paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar, e në shumën e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë ka vendosur se duke ju referuar dispozitës së nenit 8 par.1 dhe nenit 245, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), e lidhur me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021. Vendimin mbi kamatën e ka mbështetur në nenin 382 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e ka bazuar në nenin 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se, përfundimi logjik dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar në ligj, dhe se aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me kurrfarë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e as atyre nga neni 182.2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, për të cilat kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Aktgjykimi i goditur, në këtë kontest është i qartë dhe i kuptueshëm si në pjesën e arsytimit ashtu edhe në dispozitiv, ku figuron e qartë dhe e kuptueshme mënyra e vendosjes. Dispozitivi është edhe i ekzekutueshëm. E drejta materiale, për të cilën gjykata e shkallës së dytë kujdeset edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, është zbatuar në mënyrë të drejtë, gjë që ka rezultuar me miratimin e drejtë të kërkesëpadisë së paditësit në shumën e gjykuar, e që ky aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes është marrë drejtë nga gjykata e shkallës së parë pasi që janë plotësuar kushtet e parapara ligjore për marrjen e të njëjtit sipas nenit 152 dhe 398, të LPK-së, dhe nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së prandaj i njëjti vërtetohet në tërësinë e tij.

Gjykata e Apelit, për arsyet e paraqitura si më lart, në pajtim me nenin 195 par. 1 pika d) e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ca.nr.6477/2024 me datë 07.10.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari
Enes Mehmeti